

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"PRAN COMPANY LIMITED" SH.P.K**

KAPITULLI I

Emri, Forma, Selia, Kohezgjatja

Neni 1

Emri i Shoqerise

- 1.1. Emri i Shoqerise eshte " **PRAN COMPANY LIMITED** " sh.p.k ("Shoqeria"), ndjekur ne menyre te pandashme nga shkurtimi "sh.p.k", i cili perfaqeson formen ligjore te saj.
- 1.2. Ortaket e Shoqerise jene :
 - **Z. YOUSEF HAJEE AZIZUR RAHMAN** shtetas Bangladeshian, lindur me 01 Shtator 1964 mbajtes i pasaportes me Nr. BK0840073, zoterues i 75% (shtatedhjete e pese perqind) te kapitalit te shoqerise qe i korespondon 1 (nje) kuote, me vleren 750 Lek (shtateqind e pesedhjete leke);
 - **Z. ABDUL HANNAN** shtetas Bangladeshian, lindur me 04 Gusht 1979 mbajtes i pasaportes me Nr. BH0905482, zoterues i 25% (njetzet e pese perqind) te kapitalit te shoqerise qe i korespondon 1 (nje) kuote, me vleren 250 Lek (dyqind e pesedhjete leke).

Te cilet gezojne pergjegjesi te kufizuar deri ne limitin e kontributit perkates ne kapitalin e shoqerise te perfaqesuar ne kuota.

Neni 2

Forma Ligjore

- 2.1. Shoqeria eshte nje person juridik shqiptar, dhe ka formen ligjore te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, ne pajtim me ligjin nr.9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Neni 3

Selia

- 3.1. Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen: Rruga e Elbasanit, Godina Tërshana, kati i dytë, Tirane, Shqiperi.
- 3.2. Shoqeria ka te drejte te ndryshoje seline e saj ne nje adrese dhe/ose ne nje qytet tjeter te Shqiperise.
- 3.3. Shoqeria mund te hape dege te saj ose zyra perfaqesimi kudo brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise.



Neni 4.
Kohezgjatja

- 4.1. Kohezgjatja e shoqërisë është për një periudhë të pacaktuar.
- 4.2. Kohezgjatja e jetës së shoqërisë mund të ndryshohet një ose më shumë here, me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

KAPITULLI II

Objekti i Shoqërisë
Neni 5

Objekti i veprimtarive të Shoqërisë është:

- Aktivitet catering dhe restorant. Agjensi turistike. Import – eksport artukuj të ndryshëm. Tregtimin me shumicë të të gjithë artikujve. Prodhimin e lëndëve të para bujqësore. Tregtimin e këtyre produkteve brenda dhe jashtë territorit shqiptar. Importin dhe eksportin e artikujve të ndryshëm bujqësorë e blegtoralë dhe tregtimin e tyre. Prodhimin e energjisë elektrike nëpërmjet shfrytëzimit të biomasave. Gjithashtu, shoqëria mund të kryejë çdo lloj aktiviteti tjetër ekonomik, tregtar, financiar që gjykohej i dobishëm dhe i nevojshëm për realizimin e objektit të shoqërisë, përfshirë dhe shitjen e mjeteve të shoqërisë siç janë makineritë dhe pajisjet, të japi dhe të marri me qera, të hyjë garant, të hipotekojë si dhe të marri pjesë në shoqëri të tjera. Së fundi, shoqëria mund të kryejë çdo operacion tregtar, shitblerje të pasurive të luajtshme apo të paluajtshme, hipotekime, financiare dhe kreditimi, të japi garanci reale dhe personale për të tretët, të blejë, shesë ose marrë me qera ndërmarrje, degë ndërmarrjesh, si dhe të marri interesa dhe të marri pjesë në shoqëri, ente, konsorce të themeluara ose duke themeluar me objekt të njëjtë ose të afërt me qëllim të realizojë objektin e shoqërisë. Dhe në përgjithësi, shoqëria mund të kryejë veprimtari të tjera të nevojshme ose të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë. Shoqëria mund të kryejë të gjitha operacionet mbi pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, financiare, tregtare, të lidhi kontrata bilaterale aktive dhe pasive me Institute Krediti të autorizuara nga ligji edhe me firma private, të japi garanci reale për të tretët dhe gjithçka që është e nevojshme për arritjen e qëllimit të shoqërisë. Shoqëria mund të zhvillojë çdo aktivitet tjetër që është i nevojshëm për realizimin e objektit të shoqërisë. Për të vetmin qëllim të arritjes së objektit të lartpërmendur, shoqëria mund të blejë interesa, aksione, pjesëmarrje të kapitalit, në shoqëri të tjera, konsorciume ose kompani të cilat kanë objekte të ngjashme apo analoge me të vetin dhe të kryejë të gjitha veprimet komerciale, industriale dhe financiare. Në veçanti, shoqëria, mund të marrë në pronësi, uzufukt ose me qera, kompani ose degë kompanish që operojnë në fushën e një ose më shumë prej veprimtarive të mësipërme. Shoqëria mund të japë gjithashtu garanci, garanci mbi kreditë dhe depozitat, të lerë peng të mira dhe vlera të tundshme, të vendosë garanci hipotekore mbi të mirat e patundshme dhe të tundshme të regjistruara dhe të vendosë në përgjithësi çdo garanci të mundshme reale dhe personale. Të njëjtat garanci mund të vihen dhe në interes të subjekteve të lidhura me të nga raporte ekonomike ose pjesëmarrje, me përjashtim të të tjerëve.

Neni 6.
Ndryshimet

- 6.1. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj në çdo kohë siç parashikohet në këtë Statut.



KAPITULLI III

Kapitali Themeltar; Pjeset e Kapitalit Themeltar

Neni 7.

Kapitali Themeltar

- 7.1. Kapitali i Shoqerise eshte ne total 1,000 (nje mije) Leke i ndare ne 2 (dy) kuota, plotesisht te nenshkruara dhe te shlyera.

Neni 8.

Ortaket e Shoqerise dhe Kuotat e zoteruara prej Ortakeve

- 8.1. Ortaket e Shoqerise " **PRAN COMPANY LIMITED**" sh.p.k jane:
- **Z. YOUSEF HAJEE AZIZUR RAHMAN** shtetas Bangladeshian, lindur me 01 Shtator 1964 mbajtes i pasaportes me Nr. BK0840073, zotërues i 75% (shtatedhjete e pese perqind) të kapitalit të shoqërisë që i korespondon 1 (nje) kuote, me vleren 750 Lek (shtateqind e pesedhjete leke);
 - **Z. ABDUL HANNAN** shtetas Bangladeshian, lindur me 04 Gusht 1979 mbajtes i pasaportes me Nr. BH0905482, zotërues i 25% (njezet e pese perqind) të kapitalit të shoqërisë që i korespondon 1 (nje) kuote, me vleren 250 Lek (dyqind e pesedhjete leke).

Neni 9.

Zvogelimi ose Zmadhimi i Kapitalit Themeltar

- 9.1. Kapitali mund te zmadhohet ose zvogelohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme e Ortakeve, ne perputhje me Kapitullin IV te ketij Statuti, si dhe kerkesave te detyrueshme te Ligjit te shoqerive.
- 9.2. Zmadhimi i kapitalit mund te realizohet me ane te kontributeve ne para, ne natyre, si dhe duke perfshire rezerven apo fitimet apo duke konvertuar borxhet ne kapital.
- 9.3. Shoqeria nuk mund te bleje asnje kuote te saj. Megjithate me qellim zvogelimin e kapitalit te Shoqerise, nepermjet vendimit per zvogelimin e kapitalit, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te autorizoj Administratorin Firmetar te beje blerjen e kuotave perkatese dhe ti anullojne ato.

Neni 10.

Transferimi i pjeseve te Kapitalit

- 10.1. Pjeset e kapitalit transferohen tek te tretet nepermjet vendimit te leshuar nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve.
- 10.2. Cdo transferim i kuotave do te behet ne perputhje me dispozitat e Ligjit te Shoqerive, dhe duhet te regjistrohet prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.



KREU IV

Asambleja e Pergjithshme

Neni 11. **Kompetencat**

- 11.1. Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi drejtues i Shoqerise. Veprimtaria e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve rregullohet nga Ligji per Shoqerite.
- 11.2. Duke qene se shoqeria " **PRAN COMPANY LIMITED**" sh.p.k eshte nje shoqeri me 2 (dy) ortake, ne perputhje me Ligjin per Shoqerite Tregetare, te gjitha te drejtat dhe detyrimet e Asamblese se Pergjithshme do te ushtrohen nga te 2 (dy) ortaket.
- 11.3. Te gjitha vendimet e marra nga Ortaket e shoqerise do te regjistrohen ne nje regjister te vecante (regjistri i vendimeve), keto te dhena nuk mund te ndryshohen ose fshihen.

KREU V

Administratoret

Neni 12. **Administratoret dhe kompetencat**

- 12.1. Shoqeria drejtohet nga Administratoret e saj. Administratoret mund te jene te cdo kombesie dhe nuk eshte e nevojshme te jene rezident ne Shqiperi.
- 12.2. Administratoret e nje shoqerie meme nuk mund te zgjidhen administratore te Shoqerise se kontrolluar, dhe anasjelltas. Cdo emerim i bere ne kundershtim me keto dispozita eshte i pavlefshem.
- 12.3. Administratoret e Shoqerise do te jene:
 - **Z. YOUSEF HAJEE AZIZUR RAHMAN** shtetas Bangladeshian, lindur me 01 Shtator 1964 mbajtes i pasaportes me Nr. BK0840073,, ne cilesine e Administratorit firmetar
 - **Z. ABDUL HANNAH** shtetas Bangladeshian, lindur me 04 Gusht 1979 mbajtes i pasaportes me Nr. BH0905482, ne cilesine e Administratorit te Operacioneve
 - **Z. JABED HOSSAIN** shtetas Bangladeshian, lindur me 10 Janar 1980 mbajtes i pasaportes me Nr. BQ0961108, ne cilesine e Administratorit te Prokurimeve dhe Forniturave.
- 12.4. Kohezgjatja e funksionit te Administratorit eshte per nje periudhe prej 2 (dy) vjetesh, duke filluar qe nga momenti kur kjo detyre merr fuqi ligjore, me te drejte ripertesitje te ketij mandati.
- 12.5. Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve ka te drejten te emeroje dhe shkarkoje Adminstratoret e shoqerise ne perputhje me Ligjin per Shoqerite Tregetare.



Neni 13
Kompetencat dhe detyrimet

13.1. Kompetencat e Administratoreve ne kuader te perfaqesimit te Shoqerise perfshijne:

- (i) Menaxhimin e aktivitetit tregtar te shoqerise nepermjet implementimit te politikave dhe planeve te percaktuara nga Ortaket e Shoqerise.
- (ii) Perfaqesimin e Shoqerise.
- (iii) Kujdesin per mbajtjen ne menyre te pershtatshme te dokumentave dhe librave kontabel te Shoqerise.
- (iv) Pergatitjen dhe firmosjen e bilancit vjetor, bilancit te konsoliduar dhe raportit te ecurise se veprimtarise se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve qe i paraqiten per miratim Ortakeve te shoqerise
- (v) Krijimin e nje sistemi paralajmerimi per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e Shoqerise.
- (vi) Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e Shoqerise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit, kur eshte e nevojshme.
- (vii) Raportimin perpara Ortakeve, lidhur me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e Shoqerise.
- (viii) Kryerjen e detyrave te tjera te caktuara ne ligj dhe nga Ortaket.

13.2. Administratoret mbikqyrin dhe sigurojne qe zyrtaret, agjentet, te punesuarit, auditoret dhe keshilltaret e Shoqerise te veprojne me kujdesin e duhur dhe te mbrojne sa me mire interesat e Shoqerise. Administratoret duhet te raportojne tek Ortaket ne lidhje me personat te cilet emerohen nga Ortaket.

Neni 14.
Detyrimi i besnikerise dhe pergjegjesia

14.1. Pavec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 dhe 18 te Ligjit te Shoqerive, administratoret detyrohen:

- (i) Te kryejne detyrat e tyre te percaktuara ne ligj ose ne kete Statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te Shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se Shoqerise ne mjedis;
- (ii) Te ushtrojne kompetencat qe u njihen me ligj ose nga ky statut, vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
- (iii) Te vleresojne me pergjegjesi ceshtjet per te cilat merret vendim;
- (iv) Te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ato te Shoqerise;
- (v) Te ushtrojne detyrat e tyre me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem.



KREU VI

Administrimi Financiar i Shoqerise

Neni 15.

Eksperti Kontabel i Autorizuar

- 15.1. Ortaku duhet te caktoj ekspertin kontabel te autorizuar ne numrin dhe kohezgjatjen e percaktuar nga legjislacioni shqiptar.
- 15.2. Ekspertet duhet te kryejne funksionet audituese ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

KREU VII

Aktiviteti Shoqerise

Neni 16.

Viti ekonomiko-financiar

- 16.1. Viti ekonomiko-financiar fillon ne ditën e pare te muajit Janar dhe perfundon ne ditën e 31-te te muajit Dhjetor te secilit vit. Viti i pare financiar nis ne datën e themelimit te Shoqerise.

Neni 17.

Mbajtja e Llogarive

- 17.1. Shoqeria do te mbaje llogarite ne leke dhe ne monedhe te huaj ne rast se e gjykon te nevojshme.

Neni 18.

Fitimi dhe Shperndarja e Dividenteve

- 18.1. Fitimi i Shoqerise percaktohet ne baze te bilancit te aprovuar nga Ortaket e shoqerise. Shperndarja e fitimit do te caktohet nga Ortaket ne perputhje me Statutin, dhe me ligjet e zbatueshme.
- 18.2. Nga dividenti, do te caktohet nje fond rezerve ne perputhje me kushtet e legjislacionit shqiptar per fondin rezerve te detyrueshem.

KREU VIII

Modifikimi i Formes Ligjore; Prishja

Neni 19.

Modifikimi i Formes Ligjore

- 19.1. Forma ligjore e Shoqerise mund te ndryshoje me vendim te Ortakeve te shoqerise sipas dispozitave te ketije statuti dhe ne perputhje me dispozitat respektive ne Legjislacionin Shqiptar.
- 19.2. Shoqeria e re do te permbushe te gjitha procedurat ligjore te regjistrimit ne Shqiperi.



Neni 20.
Prishja e Shoqerise

20.1. Shoqeria mund te prishet ne rrethanat e meposhtme:

- (i) Si pasoje e perfundimit te kohezgjatjes per te cilin ishte themeluar;
- (ii) Me vendim te Ortakeve te saje;
- (iii) Hapje e nje procedure falimentimi;
- (iv) Nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
- (v) Me vendim gjykate;
- (vi) per arsye te tjera te parashikuara nga Ortaket ne cdo kohe.

20.2. Administratoret regjistrojne prishjen e Shoqerise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ne perputhje me nenin 43 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit". Ne rast se prishja e Shoqerise behet me me vendim gjykate, gjykata, ne perputhje me nenin 45 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", ia njofton vendimin kesaj te fundit per regjistrim.

KREU IX

Te ndryshme

Neni 21.
Ligji i zbatueshem

21.1. Kjo marreveshje rregullohet dhe interpretohet ne perputhje me ligjet shqiptare.

Neni 22.
Te tjera

21.2. Cdo ceshtje tjeter, e cila nuk eshte permendur ne kete statut, do te rregullohet nga dispozitat e Ligjit per Shoqerite Tregtare.

Emri i Shoqerise

"PRAN COMPANY LIMITED" SHPK

Date:

19-06-2019

ASAMBLEJA E ORTAKËVE TË SHOQËRISË
" PRAN COMPANY LIMITED" SH.P.K

Yousef Hajee Azizur Rahman
Yousef Rahman

Z. YOUSEF HAJEE
AZIZUR RAHMAN

ORTAK

Abdul Hannan
Abdul Hannan

Z. ABDUL
HANNAN

ORTAK

